

D E K R E T
Nr.1616, datë 20.9.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7512, DATË 10.8.1991 “PËR SANKSIONIMIN
DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË TË VEPRIMTARIVE
PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT”**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J :

Neni 1

Neni 2 i ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, ndryshohet si vijon:

“Personat juridikë dhe fizikë shqiptarë ose të huaj ushtrojnë veprimtaritë private në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Privatizimi i pronës shtetërore bëhet:

1. Shitja e kapitalit dhe transferimi i aksioneve të shoqërive tregtare me kapital shtetëror, në të cilat shteti si pronar i këtij kapitali përfaqësohet nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore të përcaktuara me ligj, bëhet nga këto ministri e institucione në bashkëpunim me Ministrinë e Privatizimeve.

2. Shitja e kapitalit dhe transferimi i aksioneve të shoqërive të tjera tregtare me kapital tërësisht ose pjesërisht shtetëror të transformuara nga ndërmarrjet shtetërore, në të cilat shteti si pronar i këtij kapitali përfaqësohet nga Ministria e Privatizimeve, si dhe shitja e kapitalit të ndërmarrjeve shtetërore të patransformuara dhe shitja e objekteve të veçanta që shkëputen nga shoqëritë e tjera tregtare, bëhet nga Ministria e Privatizimeve.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit, si institucion buxhetor në vartësi të Këshillit të Ministrave, kryen dhe organizon procedurat e shitjes të pronës shtetërore, ku shteti përfaqësohet si pronar nga Ministria e Privatizimeve.

3. Shitja e kapitalit ose transferimi i aksioneve a pjesëve shtetërore të shoqërive tregtare me kapital të përbashkët me investitorë vendas ose të huaj, në të cilat shteti si pronar përfaqësohet nga organi që ka bërë derdhjen e kapitalit në këto shoqëri, bëhet nga këto organe në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare.

Këshilli i Ministrave përcakton rregullat kryesore për privatizimin e pronës shtetërore, si dhe miraton programet e privatizimit të shoqërive tregtare, ku privatizimi i pronës shtetërore bëhet sipas pikës 1 të këtij neni.

Dhënia me qira e pronës shtetërore bëhet nga organet që përfaqësojnë shtetin si pronar të kësaj prone”.

Neni 3

Në paragrafin e tretë të nenit 23 fjalja e fundit ndryshohet si vijon:

“Ndryshimi i destinacionit brenda këtij afati mund të bëhet nga organet e përcaktuara në nenin 22 që përfaqësojnë shtetin si pronar të pronës shtetërore”.

Neni 4

Neni 25 ndryshohet si vijon:

“Privatizimi i pronës shtetërore me letra me vlerë për privatizim organizohet dhe shpallet nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit me miratim të organit që përfaqëson shtetin, si pronar të pronës

shtetërore”.

Neni 5

Nenet 10, 11, 12,13,16 dhe 24 shfuqizohen.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha